




Pusht 731

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN



VENDIM

Nr.14, datë 24.02.2022

PËR

MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR ME NR. 674/1 PORT., DATË 14.07.2017 MIRATUAR ME VENDIM NR.22 DATË 29.06.2017 NGA KBU SEMAN”, DHËNË NË FAVOR TË SHOQËRISË “BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD”

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime teknologjike, me nr. 674/1 prot., datë 14.07.2017, miratuar me vendimin nr.22, datë 29.06.2017 nga KBU Seman, dhënë në favor të shoqërisë “Bankers Petroleum Albania ltd”, me adresë Rruga: “Shën Leonardo Murialdo” Godina 37 Fier.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e pus shpimit (KRGJSH)

- X=471133.4; Y=4510926.9; Z=10.8

Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q=0.0058 \text{ m}^3/\text{s}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

